



Kuvendi i komunës së Rahovecit, duke vendosur sipas kërkesës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, të cilën e përfaqëson Bojan Pavllloviq, nga Hoça Madhe, në çështjen administrative – shpallje të pavlefshme të Vendimit të këtij Kuvendi 01 nr. 125/07 të dt. 29.06.2007, në bazë të nenit 12.2 shkronja d), dhe 17, shkronja s) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”) nr. 28/ 4 qershor 2008 nenit 93.3, 103.1. dhe 106. të Ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28, dhe nenit 5 të Statutit të komunës së Rahovecit, 01 nr. 569/1 të dt. 16. 12. 2010, Kuvendi i komunës së Rahovecit, në mbledhjen të mbajtur më 23 korrik 2015, merr këtë:

V E N D I M

I.- SHPALLET I PAVLEFSHËM Vendimi i Kuvendit të komunës së Rahovecit 01 nr. 125/07 të dt. 29. 06. 2007, me të cilën Jovan Raka Matiqit, nga fshati Bratatin, për ndërtimin e shtëpisë banesore iu është ndarë pa kompensim, ngastra komunale nr. 857/2, në vend të quajtur “Bardovc”, sipas kulturës jopjellore, në sipërfaqe prej 500 m2, z.k. Hoçë e Madhe, pasi që i përmenduri në afat prej 3 (tre) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit e deri më tani, nuk ka ndërtuar objektin banesor e as që ka kryer punimet të konsiderueshme në ndërtimin e objektit dhe ngastra në fjalë i rikthehet pronarit të mëparshëm komunës së Rahovecit.

II.- Shpallja e Vendimit të pavlefshëm 01 nr. 125/07 të dt. 29.06.2007, ndikon retroaktivisht nga momenti i marrjes dhe me shfuqizimin e tij anulohen të gjitha pasojat juridike që ka prodhuar ky Vendim (ex tunc).

A r s y e t i m

Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe, të cilin e përfaqëson Bojan Pavllloviq, nga Hoça e Madhe, me kërkesën e vet nr. 4099 të dt. 15. 06. 2015, është drejtuar Kuvendit të komunës së Rahovecit, duke kërkuar shpalljen e pavlefshme të Vendimit 01 nr. 125/07 të dt. 29.06.2007, duke theksuar përveç tjerash, se shfrytëzuesi i paluajtshmërisë në pronësinë shtetërore, Jovan Raka Matiq, nga Bratadini, në afatin e caktuar ligjor prej 3 (tre) vietve, nga dita e plotëfuqishmërisë së Vendimit e deri më tani nuk ka filluar me ndërtimin e objektit banesor, për çka janë plotësuar kushtet ligjore që ngastra nr. 857/2 në sipërfaqe prej 500 m2, të rikthehet komunës së Rahovecit.

Për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në terren, Drejtoria për kadastrë, gjeodezi dhe pronë – Sektori për pronë, e cila përgatitë lëndët për shqyrtim dhe vendosje në Kuvend, nëpërmjet ekspertit të gjeodezisë, në vendin e ngjarjes ka konstatuar se në dhënien e ngastrës komunale nr. 857/2, shfrytëzuesi, Jovan Raka Matiq, nga Bratadini, nuk ka ndërtuar kurrfarë objekti banesor e as që kjo ngastër shfrytëzohet për çfarëdo qëllimi me karakter ndërtimor.

Pasi që sipas dispozitave të Ligjit për administratën e përgjithshme, nuk është paraparë afati kur mund të shpallet i pavlershëm Vendimi, sipas kërkesës së palës ose sipas detyrës zyrtare, nuk ekziston kurrfarë kufizimi kohor me të cilën mund të anulohet ose të shpallet i pavlefshëm Vendimi me të cilën pala ka fituar një të drejtë të caktuar. Në bazë të nenit 20. al. 3. të Ligjit për tokën ndërtimore, “Gazeta zyrtare e KSAK”, i cili ka qenë në fuqi, kur është vendosur kërkesa e të përmendurit, është paraparë që personat të cilët fitojnë në shfrytëzim ngastrën ndërtimore në pronësinë shoqërore, janë të obliguar që në afat prej 3 (tre) viteve, nga dita e marrjes në dorëzim të Vendimit, të ndërtojnë ndërtesën, përkatësisht t,i kryejnë punimet e konsiderueshme në atë objekt (vuarja e objektit nën pullaz, ose kryerja e pjesës më të madhe të punëve ndërtimore të objektit). Personi i cili në afatin e caktuar ligjor nuk ndërton objektin banesor, ose nuk i kryen punimet të

konsiderueshme në atë objekt, sipas dispozitave të nenit në fjalë humbë të drejtën e përparësisë së ndërtimit, nën kushtet dhe mënyrën të cilën e cakton me Vendim Kuvendi i komunës.

Gjithashtu në bazë të dispozitave të nenit 103.1. të Ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28, akti administrativ i vlefshëm, mund të revokohet ose të shfuqizohet, në qoftë se ndryshimi i rrethanave nuk e arsyeton më ekzistencën e tij, ndërsa sipas nenit 106 të këtij ligji, parashihet që akti i mëparshëm mund të shpallet i pavlefshëm, dhe atë qoftë për shkaqe ligjore, ndryshimin e rrethanave ose kushteve që kanë ndikuar në aktin juridik.

Retroaktiviteti i Vendimit mbi ndarjen e truallit në pronësinë shoqërore, përkatësisht shtetërore në shfrytëzim, i cili nuk është zbatuar me fajin e palës, paraqet përjashtimin e tij në rast të pavlefshmërisë së Vendimit. Pasi që me dispozitat e nenit 93.3. të LPA, nr. 02/L-28, çdo palë e interesuar kurdoherë mund t'i drejtohet organit të administratës për shpalljen e Vendimit të pavlefshëm, e që për këtë nuk është paraparë kurrfarë afati ligjor për ndryshimin ose vuarjes jashtë fuqisë të aktit administrativ të plotfuqishëm, e që kjo varet nga rrethanat konkrete, ai Vendim mund të shpallet i pavlefshëm “në çdo kohë” pa marrë parasysh në kalimin e kohës

Nga arsyet të cekur më lartë është vendosur si në dispozitiv të vendimit.

U vendos pranë Kuvendit të komunës së Rahovecit më 23 korrik 2015

01 nr. 79/2015

KËSHTILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk mund të parashtrahet ankesë, por me padi mund të zhvillohet konflikti administrativ pranë Gjykatës Themelore – Departamenti për konfliktet administrative në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit.

 **REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 79/2015 Më 23.07. 2015
Br. prot. _____ Dt. _____
RAHOVEC - ORAHOVAC



Kyesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani





KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC
SKUPSTINA OPSTINA RAHOVEC
MUNICIPALITY ASSEMBLY RAHOVEC

DREJTORIA PËR GJEODOZI, KADASTËR DHE PRONË /
DREJTORIASerbian /
DREJTORIAEnglish/

KOPJE PLANI / KOPIJA PLANA / COPY OF PLAN


Zona Kadastrale / Katastarska opstina / Cadastral Zone: HOQE E MADHE

/ 71510008

Pronari, Shfrytëzuesi / Vlasnik, Korisnik / Owner, Possessor: P.SH E KOSOVES KK.RAHOVEC, SHFR

Fletëposedimi nr. / Posedovni list br. / Possession list Nr: 08/4220

Parcela nr. / Br.plana / Parcel Nr: 857-2



Data / Datum / Date: 1.7.2015 v.g

E punoi / Uradio-la / Operator: ALI KRYEZIU

Ali Kryeziu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510008-00857-2

Numri i lëndës / Broj Predmet/Case Reference Number:	08-4220
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	01.07.2015- 9:05
Komuna / Opština / Municipality:	Rahovec/Orahovac/Rahovec
Zona Kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastral Zone:	HOÇË E MADHE/VELIKA HOÇA/HOÇË E MADHE
Zyra Kadastrale Komonale / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Rahovec/Orahovac/Rahovec

Drejtori/Direktor/Director

Referenti/Referent/Referent

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastrarske jedinice Cad. unit No.	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R U/R	Sipërfaqja Površina Area m ²	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-71510008-00857-2	Parcela	R	500	21/2011 Aktive i kuve. kom. Rahovec 01 nr. 125/07 dt. 29.06.2007 rfp 2/2007	29.05.2013	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Kodi postal Poštanski fah Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
BARDOVAC-BARDOVAC/BARD- OVAC-BARDOVAC/BARDOVAC- BARDOVAC	-	//	29.05.2013	

CERTIFIKATË / CERTIFICAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT:

P-71510008-00857-2


A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISËENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korišćenja parcele Parcel type of use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korišćenje parcele Parcel current use	Klasa e kualitetit Klasa kvalitieta Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m2)
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljište/Other Land	Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive		500

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lični broj ID. no.	Vendbanimi Prebivalište Residence	Kodi postal Poštanski fab Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address Details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual/Individualna Drzavina/single possessor	P. SH. E KOSOVES K. K. RAHOVEC -SHFRYTEZUES PER 10 VITE -MATIQ JOVAN (RAKA)	KCID91411611 5	HOÇE E MADHE/HOÇE E MADHE/ HOÇE E MADHE	-	//	1/1		

Kuvendi Komunal
Rr."Xhelal Hajda-Toni"
Rahovec



Skupština Opštine
Ul."Xhelal Hajda-Toni"
Orahovac

Municipal Assembly
Str."Xhelal Hajda-Toni"
Rahovec

Kuvendi komunal Rahovec, duke vendosur sipas kërkesës së Matiq Raka Jovan, nga Bratotini, tani i zhvendosur dhe i strehuar në Hoçë të Madhe, për ndarjen e truallit në pronësinë shoqërore, në bazë të nenit 29. pika 2. Statutit të komunës së Rahovecit, nenit 11. al. 3. të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, nenit 39. të Ligjit mbi tokat ndërtimore, ("Gazeta zyrtare e Kosovës," nr. 14/80), i cili konsiderohet si ligj i aplikueshëm në Kosovë, sipas Rregullores nr. 24/1999 dhe 85/2000, si dhe nenit 13. të Ligjit mbi procedurën administrative, nr. 02/L-28 (Rregullore nr. 2006/33), merr

AKTVENDIM

I.-APROVOHET kërkesa e Matiq Raka Jovan nga Bratotini, i cili pas përfundimit të luftës me anëtarët e ngushtë të familjes është zhvendosur dhe strehuar në Hoçë të Madhe, dhe i **ndahet trualli** në shfrytëzim pa kompensim dhe pa të drejtë tjetërsimi, për ndërtimin e shtëpisë banesore, pjesa e ngastrës shoqërore nr. 857, në vend të quajtur "Bardovc", sipas kulturës jopjellore në sipërfaqe prej 0.05,00 ha, nga fleta e posedimit nr. 274 z.k. Hoça e Madhe, për deri sa të krijohen kushtet normale për t'u kthyer në pronën e tij në Bratotin, e më së shumti për 10 (dhjetë) vjet, me të drejtë vazhdimi.

II.- Nëse shfrytëzuesi i tokës ndërtimore në pronësinë shoqërore të cekur nën I. të dispozitivit, në afat prej 3 (tre) viteve, duke llogaritur nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë nuk ndërton objektin banesor, ose nuk i kryen punimet e konsiderueshme në ndërtimin e atij objekti, humbë të drejtën e shfrytëzimit në atë paluajtshmëri dhe e njëjta i kthehet KK Rahovecit.

III.- Për zbatimin e këtij aktvendimi do të kujdeset Drejtoria për kadatër, gjeodezi dhe shërbimi pronëso-juridik e KK Rahovecit.

Ar sy e t i m

Matiq Raka Jovan, nga Bratotini, i cili pas përfundimit të luftës në Kosovë, me anëtarët e ngushtë të familjes është strehuar dhe zhvendosur përkohsisht në Hoçë të Madhe, me kërkesën e vetë 08 nr. 63/07 të dt. 12. 02. 2007 është drejtuar Bordit të drejtorëve, përkatësisht Kuvendit komunal, duke kërkuar ndarjen e truallit në pronësinë shoqërore, për ndërtimin e shtëpisë banesore në pjesa e parcelës më afër të cekur në dispozitiv të aktvendimit.

I përmenduri në kërkesën e vetë përveç tjerash ka theksuar se pas përfundimit të luftës në Kosovë, me familje është strehuar dhe zhvendosur në Hoçë të Madhe në një shtëpi private duke paguar qeranë mujore për të cilën nuk ka mundësi t'i kryej ato obligime pronarit të objektit. Nëse nuk zgjidhet problemi i tijë për sigurimin e truallit sipas së cilës një organizatë humanitare ndërkombëtare, ka shprehur vullnetin që t'i ndihmojë në ndërtimin e shtëpisë banesore, por me kusht që të ketë në pronësi apo në shfrytëzim truallin adekuat, pasi që në Hoçë të Madhe nuk posedon kurrfarë paluajtshmërie, dhe nëse për shkak të nevojës së treguar komuna nuk i siguron truallin për ndërtimin e shtëpisë banesore, do të jetë i detyruar që me të gjithë anëtarët e ngushtë të familjes të braktisi komunën e Rahovecit.

Bordi i drejtorëve në mbledhjen e vetë të mbajtur më 08. 05. 2007 ka shqyrtuar kërkesën e të përmendurit dhe në bazë të konkluzës 02 nr. 314 ka propozuar, që Komiteti për politikë dhe financa dhe Asambleja komunale të njëjtën ta aprovojnë si të arsyeshme.

Kjo lëndë është ceduar Drejtorisë për kadastër, gjeodezi dhe shërbimi pronësoro – juridik, për kryerjen e punëve tekniko-administrative, e cila me ndihmën e gjeometrit Miftar Krasniqi, e në prezencën e drejtorit të ZLK Marjan Shariq dhe palës Jovan Matiq, më date 18. 04. 2007 në vendin e ngjarjes ka vërtetuar se parcela shoqërore nr. 857, sipas kulturës jopjellore është e lirë dhe ka sipërfaqe të mjaftueshme, ndërsa trualli është i përshtatshëm për ndërtimin e një shtëpie banesore, për çka është propozuar që të përmendurit nga pjesa e parcelës në fjalë, t'iu ndahet në shfrytëzim sipërfaqja prej 0.05,00 ha, pasi që i njëjti trajtohet si person i zhvendosur.

Pas aprovimit të kësaj kërkeje, obligohet Drejtoria për kadastër, gjeodezi dhe shërbimi pronësoro-juridike, që nëpërmjet ekspertit teknik – gjeometër, në vendin e ngjarjes të kryej matjen dhe inçizimin e pjesës së parcelës nr.857 dhe të hartojë kopjen e planit në të cilën do të pasqyrohet pozita, kufiri dhe sipërfaqja prej 0.05,00 ha e cila i jipjet në shfrytëzim.

Kuvendi komunal Rahovec, duke shqyrtuar kërkesën me shkresat tjera të lëndës si dhe propozimin e Bordit të drejtorëve, vendosi që kërkesa të aprovohet si e arsyeshme, meqenëse i përmenduri trajtohet si person i zhvendosur, për shkak se në rastin konkret kanë ndikuar rrethanat të krijuara pas luftës në Kosovë, të njohura në opinionin e gjërë, dhe paraqitjes së një organizate joqeveritare me seli në Prizren, e cila vepron në Kosovë, në misionin e ndihmave humanitare për rastet sociale dhe nevojtarëve tjerë, e cila ka shprehur vullnetin e lirë që si donatore t'i ndihmojë në sigurimin e materialit për ndërtimin e shtëpisë banesore.

Nga arsyerat të cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv.

U vendos pranë Kuvendit komunal Rahovec, më 29.06. 2007.

Ky aktvendim në procedurën administrative është përfundimtar. Kundër të njëjtit me padi mund të zhvillohet kontesti administrativ pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

01 nr. 125/07



Kryetari,
Esad Haxhijaha